



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Çështjet materiale që kanë ndikuar opinionin janë si në vijim:

- A1 Prezantim jo i saktë i Llogarive të Arkëtueshme në PFV për 1,147,997€.
- A2 Detyrimet kontingjente të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (neni 18), ishin të nënvlerësuara për 17,903€.
- A3 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 117,739€.
- B1 Prezantim jo i saktë i pasurive në PFV për shkak të nënvlerësimit për 559,293€, si dhe mos regjistrimi dhe mos aplikimi i sistemit e-pasuria për pasuritë nën 1,000€, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PFV.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Pejës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Çështjet materiale që kanë ndikuar konkluzionin janë si në vijim:

- A4 Komuna gjatë vitit 2021 kishte angazhuar katër (4) zyrtarë për shërbime të veçanta, pa i respektuar procedurat e prokurimit publik.
- A5 Mos zbatim i rregullores për subvencione, përfshirë thirrjen publike, dhënien e subvencionit dhe monitorimin e tyre.
- B2 Te projekti Rekonstruktimi i rrjetit në fshatrat e Rugovës, Komuna kishte shpërblyer me kontratë Grupin e operatorëve ekonomik (OE) i cili nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuar me dosje të tenderit.
- B3 Komuna kishte nënshkruar kontrata për punë në mungesë të projekteve ekzekutive.
- B4 Si pasojë e vonës në pagesën e detyrimeve financiare, komuna ishte detyruar të paguante shpenzime shtesë prej 361,710€ në emër të procedurës kontestimore/përmbartimore apo interesit për pagesë të vonuar.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Pejës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Pejës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Pejës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Pejës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Të hyrat, mos respektimi i procedurave të prokurimit, dobësitë në menaxhimin e të arkëtueshmeve, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate, si dhe dobësitë në menaxhimin e pasurive, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollin e brendshëm lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

PFV-të e Komunës të përgatitura me datë 31.01.2022 për vitin e përfunduar me 31.12.2021, nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr.01/2017. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj gjatë procesit të auditimit kemi sugjeruar menxhmentin e komunës që PFV-të të korigjohen. Më tutje, pasqyrat janë korigjuar dhe dorëzuar në ZKA, dhe në Thesar. Megjithatë, çështjet e shpalosjes së plotë të pasurive, llogarive të arkëtueshme, detyrimeve kontingjente dhe keq klasifikimi i shpenzimeve kanë mbetur me gabime gjë që të njëjtat i kemi trajtuar si çështje që ndikojnë në opinionin e auditimit.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe gjashtë (6) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Sipas Ligji Nr. 06/L005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10 në pikën 10.1 përcakton se: 1. Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: 1.1. institucioneve publike të Republikës së Kosovës dhe 1.4 Forcave Shumëkombëshe të Kosovës.

Në nenin 16 - Raporti për të arkëtueshmet tek shpalosjet e PFV të Komunës, Llogaritë e Arkëtueshme (LI.A) të tatimit në pronë janë prezantuar në vlerën 12,572,674€, ndërsa në raportin përfundimtar të Njësisë së tatimit në pronë (të nxjerr nga sistemi Protax) ishte prezantuar vlera 13,573,745€, pra LLA për tatimin në pronë janë nënvlerësuar për 1,001,071€;

Po ashtu LI.A janë mbivlerësuar për 146,926€ për 277 prona të cilat janë në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe dy (2) prona që

janë posedim të Forcave shumëkombëshe paqeruajtëse të stacionuara në Pejë. Pronat të cilat janë në pronësi apo posedim të institucioneve të Republikës së Kosovës janë të liruara nga tatimi në pronë.

Kjo ka ndodh pasi që Komuna nuk ka një funksionim efikas të kontrolleve të brendshme në azhurnimin e regjistrave të pronave dhe verifikim të tyre në peridha të parapara me ligjin për tatimin në pronë.

Ndikimi Mos azhurnimi i të dhënave të pronave dhe ngarkimi me tatim në pronë i institucioneve publike dhe organizatave të liruara nga tatimi, si dhe prezantimi i LI.A në vlera jo të sakta, ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën LI.A.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyratri Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë. Po ashtu, të komunikojë me Departamentin e Tatimit në Pronë, që obligimi i tatimit në pronë për pronat komunale dhe për ato që janë në përdorim nga Forcat shumëkombëshe paqeruajtëse të shlyhet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Nënvlërësim i detyrimeve kontigjente

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatave buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Komuna kishte nënvlerësuar detyrimet kontigjente për 17,903€ duke prezantuar listën e pretendimeve nga mësimdhënësit për paga jubilarë, shpenzimet e shujtave dhe shpenzimet e udhëtimit të punëtorëve të arsimit. Vlera totale e paraqitur në PFV ishte prej 960,000€, mirëpo vlera totale e pretendimeve ishin 977,903€.

Prezantimi jo i drejt i detyrimeve kontigjente në PFV kishte ndodhur për shkak se nuk kanë funksionuar kontrollet e brendshme në mes të personit përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të detyrimeve kontigjente dhe ZKF-së, me rastin prezantimit të tyre në PFV.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontigjente në vlera jo të sakta ndikon në nënvlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve kontigjente.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare prezantohen në Pasqyrat Financiare Vjetore sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**Gjetja**

Sipas nenit 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “shpenzimet duhet të jenë në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë”.

Në pesë (5) raste kemi identifikuar se ishin ekzekutuar pagesa në vlerë prej 117,739€ në kategori jo adekuate nga investimet kapitale. Prej tyre, 113,676€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe 4,063€ që i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive dhe prezantimi jo i plotë i tyre në PFV****Gjetja**

Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”, po ashtu neni 6 i Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjisllacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël të SIMFK-së blerjet e vitit 2021 që janë bërë për pasuri kapitale dhe jokapitale në vlerë prej 559,383€ (ku përfshihen asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi i objekteve arsimore dhe shëndetësore, etj).

Komuna kishte regjistruar pagesën me vlerë 7,465€, (promovimi i zhvillimit të turizmit në Pejë) në regjistrin kontabël të pasurive duke mbivlerësuar pasurit për këtë vlerë.

Mirëmbajtje verore e rrugëve (sanimi i rrugëve), 26,996€, nuk është duke u aplikuar zhvlerësimi edhe pse si projekt ishte finalizuar në vitin 2019.

Komuna kishte regjistruar gabimisht në regjistrin kontabël furnizimin me mobilje për zyre me vlerë 4,732€, pasi që këto ishte dashur të regjistrohen në regjistrin e -pasuria me vlerë nën 1,000€, dhe si rezultat i kësaj pasurit

kapitale janë të mbivlerësuara, ndërsa pasuritë jo kapitale janë të nënvlerësuara.

Komuna nuk kishte ofruar shpjegime për mos zbatim të kërkesës ligjore. Megjithatë, ndonëse rekomandimi përsëritet, komuna nuk ka treguar interesim që të ndër marr masa për përmirësimin e gjendjes aktuale me qëllim që të evitohen gabimet e përsëritura.

Ndikimi

Mos regjistrimi i të gjitha pasurive në një rën anë dhe regjistrimi i gabuar i tyre që janë në posedim të Komunës, rritë rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saja dhe të ketë mangësi në raportim duke bërë nënvlerësimin e pasurive në PFV.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë të drejtë dhe të saktë për qëllime të raportimit dhe që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat të veçanta ligjore

Gjetja Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, përcakton se, “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil Nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik”.

Komuna kishte angazhuar katër (4) zyrtar me marrëveshje për shërbime të veçanta pa zhvilluar ndonjë procedurë të prokurimit. Këta persona janë të angazhuar me kontratë për periudhën nga datë 12 tetor 2020 deri më 31/12/2022.

Sipas menaxhmentit të komunës, këta punëtorë janë angazhuar si pasojë e mungesës së pozitive të aprovuara në planifikimin e buxhetit dhe me qëllim që të arrihen objektivat nga arrëveshja për projektet me Unionin Europian.

Ndikimi Mos zbatimi i kriterëve të përcaktuara ligjore për angazhimin e personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, mund të cenon parimin e konkurrencës, transparencës si dhe mund të ndikoj në diskriminimin e të tjerëve.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta, të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Subvencionimi i OJQ pa Thirrje publike dhe monitorimi i dobët i tyre**Gjetja**

Sipas nenit 2.1 të rregullorës MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), përcakton që Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve, të cilat janë aplikues apo partner në aplikimet, sipas një thirrje publike për financim të projekteve dhe programeve të OJQ-ve, dhe të cilat i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje. Dhe neni 13, përcakton kriteret të cilat duhet ti përmbajë thirrja publike si: Formularin 9 / projekt-propozimin, Formularin 10 / projekt buxhetin, të dhëna për kalendarin tentativë të realizimit të thirrjes etj.

Sipas nenit 5.4 të rregullores komunale Nr. 01/2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarjen e subvencioneve jashtë thirrjes publike të komunës bëhet brenda 15 dite pune nga dita e parashtrimit të kërkesës, dhe neni 7.1 Kryetari i komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në përberje të përfaqësuesve nga fushat specifike.

Pagesa prej 14,000€ ishte bërë sipas Vendimit të Kryetarit, për përkrahje financiare të OJQ-së, "Qendrën për jetë të pavarur" në Vitomiricë, duke anashkaluar Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare, ku kërkohet konkurrueshmëri, transparencë, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim. Po ashtu, përfituesi i këtij subvencioni nuk kishte dorëzuar një projekt propozim sipas Formularit F9 të aplikacionit të projekt/programit së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10.

Ndërsa në një tjetër rast, Komuna kishte paguar 2,000€ për mbështetje financiare të blerjes së pajisjeve për ruajtjen e produkteve të rrushit, pa një vlerësim paraprak nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave por vetëm sipas vendimit të kryetarit.

Në bazë të komunikimeve me zyrtarët komunal, nuk kemi mundur të marrim ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi

Subvencionimi i OJQ-së vetëm me vendim nga kryetari pa bërë thirrjen publike, përjashton konkurrencën, transparencën si dhe ndikon në trajtimin jo të barabartë të OJQ-ve.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që mbështetja financiare për OJQ-të, të bëhet me thirrje publike sipas kriteret të përcaktuara me rregullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Kontraktimi i OE pa përmbushur kriteret

Gjetja Sipas neni 56.4 të LLP, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tek kontrata Rekonstruktimi i rrjetit në fshatrat e Rugovës në vlerë 685,605€, Grupi i Operatorëve Ekonomik (OE) fitues i këtij projekti, nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit, pasi që nuk kishte ofruar dëshmi se ka certifikata valide ISO 9001 2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë dhe ISO 14001 2015 Sistemi i Menaxhimit Mjedisor siç kërkohen me dosjen e tenderit.

Zyrtarët përgjegjës nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, e cila mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet në mënyrë cilësore sipas kërkesave të tenderit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, në mënyrë që komisionet e vlerësimit të tenderëve bëjnë vlerësim dhe krahasim të drejt të ofertave, po ashtu, të rishikoj procesin dhe të siguroj se është përzgjedhur OE i përgjegjshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mungesa e projektit ekzekutues**

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik respektivisht pika 20.13 ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në tre (3) raste, kemi vërejtur se komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues. Rastet ishin tek kontratat: Ndërtimi i kanalizimit në qytet dhe fshatra 88,268€, Rregullimi dhe infrastruktura e ujit në Komunën e Pejës, LOT 3 Pajisja e pendave devijuese me porta kontrolluese Porta Metalike 33,975€, si dhe Asfaltimi i rrugëve në Bogë të Rugovës 156,409€.

Zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungese të projektit ekzekutues, ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njërive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit, duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj me realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të afektojnë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për parane e shpenzuar.

Rekomandimi B3 Kryetari të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore

Gjetja Rregullorja MF Nr. 01/2017 për raportim financiar nga organizatat, neni 17, pika 3, parasheh se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues. Ndërsa sipas nenit 39.1 të ligjit Nr. 03/L-048 për LMFPP: Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Ne kemi identifikuar se:

Në pesë (5) raste faturat në vlerë prej 103,401€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin rreth 3 muaj.

Po ashtu, Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa direkte nga buxheti i komunës për vitin 2021 në vlerë prej 1,122,905€. Prej tyre 361,710€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës kontestimore /përmbartimore apo interesit.

Kjo kishte ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve. Po ashtu, pagesat e ekzekutuara nga thesari kanë rezultuar nga kontrata kolektive me 90% të shpenzimeve shtesë apo 326,042€.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ka ndikuar që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore për Komunën.

Rekomandimi B4 Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e buxhetuara nga komuna për tu arkëtuar në vitin 2021 ishin 3,917,465€, ndërsa kishte realizuar 4,907,146€ dhe ka pasur një rritje prej 989,681€, në krahasim me vitin 2020. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë (2,455,933€), të hyrat nga lejet e ndërtimit (1,031,104€) dhe të hyra tjera si: taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja etj. në vlerë totale 1,420,109€. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjjobat në trafik në vlerë prej 828,837€ dhe gjjobat e gjykatave 53,130€.

Çështja A6 - Mos raportimi i të hyrave të arkëtuara nga Teatri "Istref Begolli"

| | |
|-----------------------|---|
| Gjetja | <p>Ligji Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, neni 16, Pranimi i parave publike 16.1 Asnjë autoritet publik, person ose ndërmarrje nuk do të pranojë para publike, përveç nëse autorizohet shprehimisht në bazë të një ligji ose rregullore ose me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit. Neni 16.2 Të gjitha të ardhurat e një autoriteti publik ose ndërmarrje të kontrolluar publike depozitohen në një llogari zyrtare bankare në pajtim me aktet nënligjore.</p> <p>Teatri i Qytetit "Istref Begolli" mbikëqyret nga drejtoria për kulturë dhe sport në komunë, i cili mbledh dhe shpenzon të hyra me para në dorë, por nuk i raporton dhe nuk i dorëzon në Llogarinë e Vetme të Thesarit (LIVTh). Teatri, gjatë vitit 2021 ka inkasuar të hyra nga shitja në vlerë 1,238€, të cilat nuk i ka dorëzuar dhe raportuar në LIVTh.</p> <p>Drejtoria e komunës për kulturë dhe sport, nuk e ka menaxhuar këtë situatë, prandaj, rrjedhimisht edhe funksionimi i kontrolleve në këtë aktivitet nuk ka funksionuar.</p> |
| Ndikimi | <p>Mos raportimi i të hyrave tek njësia e të hyrave në komunë, shpie në mosdeklarim të të hyrave dhe rrjedhimisht mund të rritë rrezikun që parat publike të keqpërdoren. Kryerja e aktiviteteve të mësipërme është jashtë kornizës ligjore mbi arkëtimin dhe shpenzimin e parasë publike dhe nuk mundëson kontrolle adekuate ndaj këtyre burimeve.</p> |
| Rekomandimi A6 | <p>Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të vendosur kontrollet e brendshme në mënyrë që të gjitha të hyrat e mbledhura dhe shpenzimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe sipas kërkesave ligjore.</p> |

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mangësi në bazën e të dhënave për tatimin në pronë

Gjetja Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronë të Paluajtshme përcakton që: Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, si dhe paragrafi 4 përcakton që: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Ne kemi identifikuar se 25 tatimpagues janë përfitues në dy vendbanime parësore që është në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Shkaku i ndodhjes është neglizhenca e zyrtarëve kompetent për të verifikuar dhe përditësuar të dhënat në regjistrin e tatimit në pronë.

Ndikimi Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë, rritë rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 14,930,663€, prej tyre ishin shpenzuar 14,902,939€ apo rreth 100%.

Çështja A7 - Mangësi në Listën e pagave dhe mos zbatimi i vendimeve gjyqësore

Gjetja

Rregullorja Nr.02/2018 për procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në KPMSHCK neni 18.1, Vendimi i këshillit paraqet vendim administrative të formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i cili ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Zbatimi duhet të bëhet Brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Ligji për procedurë përmbarimore nr.04/L-139 në nenin 5 par.2: "Gjykata kompetente ka kompetence lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij Ligji përveç nëse gjykatat dhe autoritetet tjera përmbaruese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës. Ndërsa në nenin 5, par. 6, përcakton: "Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbarimit dhe të zbatoj përmbarimin e vendimeve gjyqësore lidhur me:

- të gjitha çështjet nga e drejta familjare;
- kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.

Në Listën e pagave të nëpunësve të Komunës në Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në pozitën Drejtor i NjAB figurojnë dy persona me koeficientin pagë fikse 1,178€.

Drejtori i mëparshëm i emëruar në këtë pozitë në vitin 2012, ishte suspenduar dhe shkarkuar me Aktvendimin Nr.426/15 të datës 27/07/2015. Pas ankesës së tij në Këshillin e Pavarur për Mbikëqyrjen e Shërbyesve Civil (KPMSHC) me Vendimin Nr. A/02/428/1/2015 të datës 04/12/2015, kishte obliguar Komunën që ta kthej në pozitën e mëparme. Komuna me datë 08/01/2016 kishte ftuar nëpunësin që të paraqitet në punë në pozitën Drejtor i Auditimit. Mirëpo, Kryetari i Komunës me datë 13/01/2016 me Vendimin nr. 01-112-4030 kishte vendosur që ta transferoj dhe emëroj në vendin e punës Inspektor komunal me koeficientin 7 (shtatë) të pagës me arsyetimin se nëpunësi civil e ka të skaduar Licencën për Auditim të brendshëm.

Për më tepër, drejtori i NjAB-së, kishte paraqitur propozim për përmbarim në Gjykatën Themelore në Pejë për ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK-së për kthimin e tij në vendin e punës, me ç'rast Gjykata e Pejës në procedurën përmbarimore ka aprovuar kërkesën e Drejtorit të NjAB-së të pezulluar, ndërsa ka refuzuar ankesën e Komunës së Pejës ndaj aktvendimit të Gjykatës së Pejës për kthimin e tij në vendin e punës. Pavarësisht kësaj, Komuna e Pejës që nga viti 2016 nuk e ka kthyer atë në pozitën e drejtorit të Auditimit të Brendshëm. Si rrjedhojë, Gjykata Themelore në Pejë në procedurën përmbarimore në tri raste ka gjobitur Komunën e Pejës për shkak të mos zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë për kthimin e tij në vendin e punës në shumën totale prej mbi 16,000€. Megjithatë, zyrtari edhe pse nuk është sistemuar askund në vend

të punës, që nga viti 2016 vazhdon të paguhet me pagë 50% (bruto 881€ në muaj), si dhe ka vendim përmbarimor Nr E.nr 474/21 të datës 24/11/2021 për 50% tjetër të pagës së papaguar me një obligim prej gjithsej 33,711€, i mbetur për tu paguar në vitin 2022.

Në anën tjetër, me vendimin Nr. 01-112/01-130163/2017 të datës 13/11/2017, në pozitën Ushtrues detyre i drejtorit të NJAB-së, ishte caktuar një tjetër nëpunës i auditimit të brendshëm që ende vazhdon.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos zbatimit në tërësi të Vendimit ekzekutiv të KPMSHCK-së dhe vendimeve të Gjykatës Themelore të Pejës dhe Gjykatës së Apelit, me arsyetimin e menaxhmentit se nëpunësi e kishte të skaduar Licencën për auditor të brendshëm, edhe pse komuna kishte bërë ankesa në të gjitha fazat e kësaj procedure ku në fund iu është refuzuar ankesa nga gjykata e apelit për prapsimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

Ndikimi

Mos zbatimi i vendimit ekzekutiv të KPMSHCK, dhe vendimeve gjyqsore, ka si pasojë që pozita e Drejtorit të brendshëm të mbetet e pa definuar dhe që në listën e pagave të jenë dy persona në pozitë të njëjtë dhe kjo bie ndesh me Ligjet dhe rregulloret në fuqi për nëpunës publik. Për më tepër, mos zbatimi i vendimeve gjyqësore, ka ndikuar që të demtohet buxheti i Komunës me pagesa shtesë të gjobave të shqiptuara dhe procedurave përmbarimore e që në fakt kjo mund të vazhdojë ende.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të ndërmarr veprime të duhura që në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet ekzekutive të KPMSHCK dhe gjykatave kompetente të sqaroj dhe të zgjidhë këtë çështje ashtu që NjAB të ketë të emëruar një Drejtor të NjAB-së të zgjedhur me konkurs dhe të revokohet vendimi për ushtrues detyre i Drejtorit të NJAB-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 524,500€, prej tyre ishin shpenzuar 469,590€ apo 90% e buxhetit. Komuna kryesisht ka mbështetur aktivitetet kulturore, sportive si dhe ka ndihmuar bujqit, fermerët dhe qytetarët në nevojë.

Çështja A8 - Menaxhim i dobët i subvencioneve

Gjetja

Sipas nenit 1 të marrëveshjes për donacion pika B, përfituesi i donacionit pranon se ka kuptuar se do të jetë kujdestar i donacionit të dhënë që të mbajë dele për tre (3) vite të plota kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje. Pastaj pika D e marrëveshjes, parasheh që përfituesi garanton se do të kujdeset për delet në formën më të mirë të mundshme. Ndërsa sipas nenit 3, në rast të shkeljes së cilësdo pikë të kësaj marrëveshje nga ana e përfituesit, atëherë donatori ka të drejt të tërheq donacionin që i ka dhuruar përfituesit dhe të paraqes rastin në gjykatën kompetente.

Sipas nenit 26.1 të rregullores komunale Nr. 01/2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, përjashtohet nga procesi i vlerësimit të kërkesave për ndarje të subvencioneve, anëtarët e komisionit për vlerësim nëse janë në konflikt të interesit.

Te projekti për subvencionim me dele me vlerë totale të projektit 211,618€, ku Komuna ishte bashkë financuese me organizatën Islamic Relief në Kosovë (particimi i organizatës 137,552€, ndërsa Komuna me 74,066€) ishin përkrahur 15 përfitues, ku në një rast kemi identifikuar se komisioni komunal për monitorim të projektit të subvencionimit me dele, kishte organizuar vizitë në teren për verifikim vetëm tek një nga përfitueset e deleve. Sipas procesverbalit të komisionit dhe vizitës që iu është bërë nga auditori, përfituesi kishte deklaruar se nuk i ka më delet, derisa as komuna as bashkë financuesi i projektit nuk kishin ndërmarr veprime për kthimin e subvencionit.

Po ashtu tek i njëjti projekti për subvencionim me dele, një nga përfituesit e subvencionit me dele është edhe bashkëshortja e anëtarit të komisionit të vlerësimit dhe shpërndarjes së deleve që paraqet konflikt të interesit.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi

Moszbatimi i marrëveshjeve për subvencione, ndikon që të mos arrihen qëllimet e subvencionimit të fermerëve për zhvillimin e ekonomisë lokale. Poashtu, përfitimi i subvencioneve të familjarve që janë pjesë e komisionit të vlerësimit dhe shpërndarjes së subvencioneve, përveç që është e kundërligjshme ndikon në besueshmërinë që procesi është i drejt dhe transparent.

Rekomandimi A8

Kryetari të sigurohet se në të gjitha rastet kur përfituesit e subvencioneve nuk janë duke i zbatuar marrëveshjet e pranimi të subvencioneve, të ndërmerren masa që të kthehen subvencionet duke e respektuar të gjitha pikat e marrëveshjes së nënshkruar mes palëve. Gjithashtu, të vendosen masa adekuate të kontrollit që anëtarët e komisionit të vlerësimit të aplikacioneve për subvencione mos të jenë në konflikt të interesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 19,155,272€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 12,572,674€, taksa në ushtrim të veprimtarisë biznesore 6,391,030€, si dhe të tjera 191,568€.

Çështja B6 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr.06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove. Neni 27- Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk ka arritur të përgatit një plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarr veprimet e kërkuara sipas legjislacionit.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Sipas Pasqyrave Vjetore Financiare të vitin 2021 në raport me vitin paraprak, ato janë rritur për 344,969€. Rritja më e madhe ishte te tatimi në pronë i cili ishte i ndikuar edhe nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë veprimi i pamjaftueshëm i komunës, që përmes organeve të drejtësisë të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.

Ndikimi Mos angazhimi dhe mos ndërmarrja e veprimeve për arkëtimin e të hyrave, ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës. Ky mos veprimi ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të këtyre llogarive dhe nga ana tjetër ndikohet trendi negativ i rritjes vit pas viti duke rrezikuar vjetrimin e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjensin Kosovare të Privatizimit lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre. Po ashtu, Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve, duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj borxhinjëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁶ | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet | 2019 Shpenzimet |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e fondeve | 27,410,165 | 28,595,211 | 28,071,128 | 29,725,920 | 26,583,241 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 23,492,700 | 23,507,116 | 23,398,357 | 24,642,123 | 21,394,389 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 68,088 | 68,088 | 186,282 | 66,731 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 893,937 | 873,599 | 579,274 | 702,298 |
| Të hyrat vetanake | 3,917,465 | 3,917,465 | 3,586,402 | 3,320,700 | 3,959,760 |
| Donacionet vendore | 0 | 40,249 | 14,777 | 27,000 | 45,600 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 168,356 | 129,905 | 970,541 | 414,462 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,185,046€. Kjo rritje është rezultat i rritjes nga granti qeveritar prej 14,416€, financimit nga fondi i huamarrjes prej 68,088€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak 893,937€, si dhe rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme me 208,605€.

Në vitin 2021, Komuna e Pejës ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar ose 28,071,128€ me një përmirësim prej 3% në krahasim me vitin 2020, ku realizimi ishte 95%.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet | 2019 Shpenzimet |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 27,410,165 | 28,595,211 | 28,071,128 | 29,725,920 | 26,583,241 |
| Pagat dhe mëditjet | 14,813,275 | 14,930,663 | 14,902,939 | 14,686,862 | 13,777,194 |
| Mallrat dhe shërbimet | 3,476,709 | 3,641,128 | 3,582,232 | 4,132,109 | 3,015,539 |
| Komunalitë | 748,455 | 773,455 | 764,949 | 726,471 | 729,989 |
| Subvencionet dhe transferet | 374,500 | 524,500 | 469,590 | 471,545 | 334,878 |
| Investimet Kapitale | 7,997,226 | 8,725,465 | 8,351,418 | 9,708,932 | 8,725,640 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 117,388€. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së grantit qeveritar në shumë prej 17,917€, granteve të përcaktuara të donatorëve 36,733€ dhe financimeve nga huamarrjet në shumë prej 62,738€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 164,419€, kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shumë prej 68,937€, Grandeve të përcaktuara të donatorëve 98,982€, si dhe zvoglimi i grantit nga rishikimi i buxhetit në shumë prej 3,500€.
- Buxheti final për shërbimet komunale ishte rritur për 25,000€ si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 150,000€, si rezultat i të hyrave të bartura në shumë 150,000€.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 728,239€, kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në shumë prej 650,000€, granteve të përcaktuara të donatorëve 72,889€ dhe huamarrjes në shumën prej 5,350€. Një pjesë e kësaj rritje të buxhetit është dedikuar për projektet të reja si participimi në projekte me donator dhe ministrisë së linjës, mjete konkretizimi, pajisje teknologjisë informative etj. Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 551,140€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e buxhetuara nga komuna për tu arkëtuar në vitin 2021 ishin 3,917,465€, ndërsa kishte realizuar 4,907,146€ dhe ka pasur një rritje prej 989,681€, në krahasim me vitin 2020. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë (2,455,933€), të hyrat nga lejet e ndërtimit (1,031,104€) dhe të hyra tjera si: taksat administrative, të hyrat nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja etj me vler 1,420,109€.

Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 828,837€ dhe gjobat e gjykatave 53,130€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2021 Pranimet | 2020 Pranimet | 2019 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Totali i të hyrave | 3,917,465 | 3,917,465 | 4,907,146 | 3,470,296 | 3,825,002 |
| Të hyrat tatimore | 2,422,217 | 2,422,217 | 2,455,933 | 1,412,091 | 1,934,046 |
| Të hyrat jo tatimore | 1,495,248 | 1,495,248 | 2,451,213 | 2,048,205 | 1,890,956 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | | 10,000 | |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Komunës së Pejës ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna e Pejës kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2021, tetë (8) rekomandime janë zbatuar dhe gjashtë (6) të pazbatuara, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2020 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|---------------------|---|---|-----------|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj ndarja e subvencioneve të bëhet në përputhje me kriteret e vendosura si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues. | Nga testimet tona kemi vërejtur se rekomandimi ishte zbatuar, ku thirrjet publike ishin në pajtueshmëri me rregulloren, përfituesit plotësonin kriteret e kërkuara dhe komuna kishte caktuar zyrtarë monitorues të përfituesve. | I zbatuar |

| | | | | |
|----|--------------------------------------|---|--|-------------------------|
| 2. | Të hyrat | Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtëshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. | Nga testimet tona kemi verejtur se rekomandimi ishte zbatuar. | I zbatuar |
| 3. | Të hyrat | Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax. | Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 4. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se në procesin e vlerësimit të ofertave të respektohen plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit duke siguruar që vetëm operatorët ekonomik që i përmbushin kriteret të shpërblehet me kontratë. Po ashtu me rastin e vendosjes së kriterëve të mos vendosen kriteret që ndikojnë në kufizim të konkurrencës. | Nga testimet tona te kategoria e mallrave dhe shërbimeve nuk kemi hasur në raste të tilla. | I zbatuar |
| 5. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari duhet të siguroj se gjatë realizimit të kontratave kornizë do të respektohen kriteret ligjore sa i përket tejkalimit të kuotave plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicion/artikull. Në të kundërtën duhet të respektohet dispozita ligjore për ndërprerjen e kontratës kur ka devijim të sasisë apo vlerës mbi kuotën ligjore. Më tutje, Kryetari duhet të sigurojë një komunikim/bashkëpunim më të mirë ndërmjet departamentit të prokurimit dhe njësisë kërkuese në mënyrë që të mos nënshkruhen dy kontrata për furnizim me artikuj të njëjtë. | Nga testimet tona kemi verejtur se rekomandimi ishte zbatuar. | I zbatuar |
| 6. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara duke respektuar kriteret e rregullores për subvencionim të OJQ-ve. | Nga testimet tona kemi verejtur se rekomandimi ishte zbatuar. | I zbatuar |
| 7. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të siguroj kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore që me rastin e kontraktimit të punëve duhet të hartohen paraprakisht projektet ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara të njësisë kërkuese. Po ashtu duhet të siguroj që projektet ekzekutive të mos punohen nga ana e OE. | Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. | Nuk ka filluar zbatimin |

| | | | | |
|-----|-------------------------|--|---|------------------------|
| 8. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të shtojë kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik dhe të mos hyj në obligime pa mbulesë financiare. Më tutje, duhet të siguroj që për të gjitha kontratat krahas vonesave në realizimin e punimeve të zgjatet edhe siguria e ekzekutimit. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherëve të kontratave që në raportin e pranimit të përfshihen vetëm punët e realizuara. | Nga testimet tona kemi vërejtur se rekomandimi ishte zbatuar. | I zbatuar |
| 9. | Investimet kapitale | Kryetari të siguroj kontrole të shtuara në mënyrë që të bëhet vlerësim i drejtë i ofertave dhe të respektohen plotësisht kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit duke siguruar që vetëm operatorët që i përmbushin kriteret të shpërblehet me kontratë. Më tutje, lidhur me rastin e cekur më lartë të inicohet procedura ligjore ndaj OE sipas legjislacionit përkatës. | Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 10. | Investimet kapitale | Kryetari të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa. | Nga testimet tona kemi vërejtur se rekomandimi ishte zbatuar. | I zbatuar |
| 11. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë se bëhet shpronësimi i pronave private para investimit/ndërtimit të rrugëve dhe kjo të trajtohet në bazë të dispozitave ligjore para inicimit të tenderimit për ekzekutim të projekteve kapitale - ndërtim/zgjerim të rrugëve. | Nga testimet tona kemi vërejtur se rekomandimi ishte zbatuar. | I zbatuar |
| 12. | Pasuritë | Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plot të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna. | Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 13. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për ulje të llogarive të arkëtueshme. | Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 14. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të ngritë kontrole shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara. | Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Senver Morina, Anëtar i ekipit




Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Pejës
Municipality of Pejë
Opština Peč



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Gazmend MUHAXHERI

Kryetar i Komunës së Pejës

Data: 10 qershor 2022, Pejë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Participim për mbështetje fermerëve përmes IRW 74,066€; Bashkëfinancim në projektin zgjerimi i vip dinar. më rajonin e bc.shcqjp.kosov, 20,000€; Bashkëfinancim për projektin transh. mes kufitar Kosovë dhe Mal të Zi, 11,231€; Krijimi i punësimit në bujqësi, 8,379€; Pajisje të teknologjisë informative-donacion, 4,063€.
- ⁵ Vendim gjyqi pnr 104/2018, 89, 997€; Sigurimi i hapësirave publike në fshatrat Zahaq Llabjan, 11,680€; Blerja e pajisjeve sportive ne shkolla, 11,438€; Ndërtimi i çerdhes në lagjen Karagaq, 46,308€; Ndërtimi i pendës dhe kanalit të ujit në fshatin Zahaq, Ramun dhe Glaviqic, 33,975€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.